



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 21.08.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje uniforma dhe veshje, çizme plastike kundër ujit dhe veshje të papërshkueshme nga uji për punonjësit e MZSH”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Veshje i papërshkueshëm nga uji 18221000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.744.410 (një milion e shtatëqind e dyzet e katër mijë e katërqind e dhjetë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.168 e nr.7575 prot., datë 23.06.2025 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përlllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje, çizme plastike kundër ujit dhe veshje të papërshkueshme nga uji për punonjësit e MZSH”. Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025-2027 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur preventivin dhe specifikimet teknike të hartuara nga grupi i specifikimeve teknike.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës , objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

II. PËRLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76 e 42 sipas të cilit: *“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmime të botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe çmimet e tregut; ose/dhe, çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara”.*

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve u vërejt se:

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.
3. Grupi u mbështet: Në hetimin e tregut vendas, nisur nga kriteret e përcaktuara nga komisioni, në përzgjedhjen e disa firmave.

Pas shqyrtimit të të dhënave dhe informacionit të mbledhur, mbështetur në rezultatin e sipërnxjerrë, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës rezulton të jetë: 1.744.410 (një milion e shtatëqind e dyzet e katër mijë e katërqind e dhjetë) Lek pa TVSH.

Afatet e lëvrimit: 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike, nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Garancia e mallit do të jetë sipas specifikimeve teknike, bashkëngjitur.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 2 (dy) vitet e fundit financiare (2023, 2024), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet

se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapu e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti i tij) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë

subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenit 55 pika 4, germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë dhe/ ose të njëvlefshme, të cilat do të garantonin cilësinë e produktit ose standart ISO më e vancuar, ku të jetë i përcaktuar objekti i prokurimit për Blerje

uniforma dhe veshje, çizme me hekur në maje kundra ujit dhe veshjet e pa përshkueshme nga uji (Gjoksore) (e përkthyer e noterizuar). Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në zbatim të nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.”

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 OE duhet të paraqesë prospekte teknike/ kataloget origjinale (ose kopje të noterizuar) perkates ose ekuivalent i tyre, ku të tregohen karakteristikat teknike të ofruar, të cilat duhet të përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik dhe se të gjitha të jene sipas vendimi nr. 153 datë 24.12.2020 për miratimin e uniformes, shenjavedalluese perkatese, flamurit dhe stemesse shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, ku duhen të behen 100% sipas këtij vendimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 40, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 5 të VKM– së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar).

2.4.3 Deklaratë e Operatorit Ekonomik që merr përsipër furnizim e mallrave objekt prokurimi, në çdo kohë sipas kërkesave të AK në sasinë dhe cilësinë e kërkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III “Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:

*“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike. Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi. Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit